

PORTFOLIO



DEVELOPMENT SOLUTIONS

Development Solutions është bashkim i profesionistëve që udhëhiqen nga parimi i qëndrueshmërisë sa herë që propozojnë, zhvillojnë dhe zbatojnë një ide a zgjidhje. Ne besojmë që Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së janë korniza më adekuate zhvillimore për t'i adresuar sfidat aktuale globale dhe lokale. Përkthimi dhe zbatimi i këtyre objektivave në nivel lokal është oferta jonë e bashkëpunimit me aktorët zhvillimorë të Kosovës.

☎ (+383) 46 194 079
✉ info@dsolutions.al
🌐 www.dsolutions.al
📍 Ahmet Krasniqi C3 H2,
Nr. 17, 10000 Prishtinë



PROGRAMI ZHVILLIM I QËNDRUESHËM EKONOMIK

Anëtarësimi në Bashkimin Europian kalon përmes një ekonomie funksionale tregu dhe aftësie për t'u përballur me konkurrencën dhe forcat e tjera të tregut brenda BE-së. Kosova është në hapat fillestarë të ndërtimit të një ekonomie funksionale tregu. Vendi ka nevojë të përmirësojë mjedisin e të bërit biznes dhe nxisë ndërmarrësinë, të rrisë eksportet dhe zvogëlojë deficitin tregtar, njëherit duke e luftuar ekonominë informale dhe rritur punësueshmërinë. Development Solutions ofron partneritet në adresimin e sfidave të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në disa nga fushat e përparësisë krahasuese të vendit:

- 1 Turizëm i qëndrueshëm
- 2 Bujqësi dhe zhvillim rural
- 3 Ndërmarrësi, industri dhe inovacion
- 4 Promovim i investimeve
- 5 Zhvillim i arsimit dhe lidhja me tregun




PROGRAMI 1: ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM EKONOMIK



PROGRAMI MBROJTJE E MJEDISIT DHE EFIQENCË ENERGJETIKE

Shteti i Kosovës ka intensifikuar përpjekjet për t'u përballur me sfidat mjedisore dhe ndryshimet klimatike. Shëndeti i qytetarëve është drejtpërdrejtë i ndikuar nga cilësia e ajrit, uji dhe sistemet nëntokësore, menaxhimi i mbetjeve dhe burimet e ndotjes. Në veçanti, vendi ka nevojë për politika dhe programe efektive në sektorin energjetik. Development Solutions konbinon përvojën e ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë në ofrimin e ekspertizës në sferat:

- 1 Menaxhim i integruar i mbetjeve
- 2 Reduktim i ndotjes (mënjanim i burimeve)
- 3 Efiqencë energjetike
- 4 CSR mjedisor
- 5 Planifikim dhe zhvillim hapësinor



PROGRAMI 2: MJEDIS DHE EFIQENCË ENERGJETIKE



PROGRAMI INSTITUCIONE DEMOKRATIKE DHE ADMINISTRATË EFIKASE

Institucionet e Kosovës vazhdojnë të zbatojnë detyrimet e procesit të integritetit evropian që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit. Rrugë e gjatë mbetet për t'u përshkruar në konsolidimin e sundimit të ligjit dhe përmirësimin e parametereve të transparencës dhe llogaridhënies. Në ndërtimin e një kornize strategjike për reformën e administratës publike, institucionet duhet të rrisin angazhimin për përmirësimin e performansës në zhvillim të politikave, menaxhim të financave publike, menaxhim të shërbimit civil, llogaridhënien e administratës dhe ofrim të shërbimeve. Development Solutions ofron programe të përshtatura në:

- 1 Politika për zhvillim të qëndrueshëm
- 2 Zhvillim i shkathtësive të shërbyesve civil
- 3 Efiqencë në ofrimin e shërbimeve
- 4 Vlerësim i performansës institucionale
- 5 Reformë e administratës publike



PROGRAMI 3: INSTITUCIONE DEMOKRATIKE DHE EFIKASE



PROGRAMI SIGURI SOCIALE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME

Ndonëse përqindja e kosovarëve që jetojnë në varfëri është në tkurrje, niveli i përgjithshëm mbetet shqetësues. Institucionet vazhdojnë të përballen me vështirësi në zbatimin e skemave të përkujdesjes sociale dhe rritjen e punësueshmërisë së grave dhe të rinjve. Shpëzimet publike për shëndetësi duhet të rriten në vazhdimësi, ndërsa paralelisht duhet siguruar qasje të shtresave të varfra në shërbime shëndetësore dhe funksionalizuar sistemin e informacionit shëndetësor. Komunitetet jo-shumicë duhet të gëzojnë përkujdesje të veçantë sociale dhe shëndetësore, si parakusht për integrimin e tyre shoqëror. Development Solutions angazhohet në programe të specializuara të mirëqenies:

- 1 Përmirësim i parametereve të shëndetit publik
- 2 Përkujdesje sociale për grupet e disavantazuara
- 3 Sistem i informacionit dhe menaxhimit shëndetësor
- 4 Integrim i komuniteteve jo-shumicë
- 5 Promovim dhe edukim mbi të jetuarit të shëndetshëm



PROGRAMI 4: SIGURI SOCIALE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME



PROGRAMI SHOQËRI CIVILE DHE MEDIA VIBRANTE

Shoqëria civile dhe mediet vazhdojnë të kenë rol qendror në nxitjen e debatit demokratik dhe zhvillimin e zbatimit e politikave publike në Kosovë. Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile dhe entiteteve mediale garanton avansimin e vendit në rrugën e demokratizimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Development Solutions ofron ekspertizë në disa sfera të zhvillimit të brendshëm dhe programimit për OJQ-të dhe mediet:

- 1 Planifikim dhe zhvillim strategjik
- 2 Qëndrueshmëri institucionale dhe financiare
- 3 Zhvillim rajonal dhe ndërkombëtar
- 4 Rrjetëzim dhe avokim efektiv
- 5 Cilësi e programit medial dhe ndërtim i audiencës



PROGRAMI 5: SHOQËRI CIVILE DHE MEDIA VIBRANTE